



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 249, Datë 25.11.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
METODOLOGJINË E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI
I ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nënpikës 3.5 të pikës 3 të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 8 të Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 06.03.2020; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe “Marrëveshjes kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës” të datës 21.10.2021, nënshkruar nga ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a., dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/3 prot., datë 25.11.2024 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi fillimin e procedurës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” dhe “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 100, datë 27.05.2024, ka miratuar “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.
- OST sh.a. me shkresën nr. 4536/2 prot., datë 10.09.2024, me lëndën “Përcjellëse e propozimit të “Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës” dhe “Procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda të njëjtës ditë Shqipëri-Kosovë” ka kërkuar miratimin e ndryshimeve në këto dy dokumente.

- ERE, me shkresën nr. 4536/2 prot., datë 30.09.2024, ka kërkuar nga shoqëria OST sh.a. që të evidentojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara në dokumentacionin e përcjellë me shkresën nr. 4536/2 prot., datë 10.09.2024. Po ashtu, është kërkuar që për secilin ndryshim të propozuar të paraqiten argumentet dhe arsyet përkatëse, për të mundësuar vijimin e procedurës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
- Më tej, OST sh.a., me shkresën nr. 4536/4 prot, datë 31.10.2024, me lëndën “Kthim përgjigje lidhur me shkresën tuaj nr. 1899/1 prot., datë 30.09.2024,” ka propozuar disa shtesa dhe ndryshime.
- Ndryshimet e propozuara nga OST sh.a. përfshijnë disa shtesa dhe përmirësime në metodologjinë aktuale të shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni, si më poshtë cituar:
 - **Në pjesën hyrëse ("Duke pasur parasysh që:"),**
 - **Pika 6: është:** “(6) OST, KOSTT dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës përgatitën Metodologjinë për shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni (në tekstin e mëtejme referuar si ("**Metodologjia CID**")"). **Propozohet të shtohet fjalia "Metodologjia CID duhet të mbuloj shpërndarjen e të ardhurave nga kongjestioni si për periudhën e ditës në avancë ashtu edhe brenda të njëjtës ditë."**
 - **Pika 8: është** (8) Metodologjia CID është strukturuar në dy pjesë. Së pari, përcaktimi dhe mbledhja e të ardhurave të kongjestionit të krijuara nga alokimi implicit i kapaciteteve në bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë (në tekstin e mëtejme referuar si ("**AL- KS DAC**"). Së dyti, shpërndarjen e të ardhurave të kongjestionit të mësipërm, ndërmjet OST dhe KOSTT. *Në fjalinë e dytë: pas fjalive "në bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë", **propozohet të shtohen fjalët " dhe tregut brenda ditës"***
 - **Pika 9: është** (9) Kjo metodologji CID e propozuar nga OST-të dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës i paraqitet për miratim Rregullatorëve përkatës në përputhje me Nenin 6 të Marrëveshjes Kornizë. *Në fillim shtohet fjala "**Si përfundim**"*
 - **Në Nenin 1 – Qëllimi dhe objekti, në pikën 1, shtohet paragrafi "d":** *me këtë përmbajtje "Të ardhurat nga kongjestioni që vijnë nga alokimi i kapaciteteve në harkun kohor brenda ditës".*
 - **Në Nenin 3 – Përkufizimet dhe interpretimi, Pika 3, gërma "b": është:** përveç nëse nuk specifikohet ndryshe, termat e përdorur zbatohen në kontekstin e bashkimi të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri-Kosovë (ALKS DAC); *pas fjalëve "bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë (AL-KS DAC)" shtohen fjalët "dhe AL-KS IDA (bashkimit të tregut të energjisë elektrike brenda të njëjtës ditë Shqipëri - Kosovë)."EMCS" shtohen fjalët "për AL -KS DAC dhe AL -KS IDA"*
 - **Në Nenin 5 – Parimet për ndarjen, në pikën 1 e cila është:** OST dhe KOSTT, do të marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare bazuar në një koeficient të ndarjes 50% me 50%. Detajet si dhe arsyet themelore përcaktohen në Shtojcën 1 të kësaj metodologjie. *Pas togfjalëshit "të ardhurave neto kufitare" shtohen fjalët "AL-KS DAC dhe AL-KS IDA"*
- Këto shtesa dhe ndryshime të propozuara nga OST sh.a. evidentohen si propozime në kuadër të implementimit të tregut të organizuar me shumicë brenda të njëjtës ditë. Shtesat dhe ndryshimet nuk ndryshojnë parimet e metodologjisë në fuqi të miratuar nga ERE, por zgjerojnë fushën e veprimit të saj duke përfshirë edhe tregun brenda të njëjtës ditë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Metodologjinë e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni i Energjisë Elektrike Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI